

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Shtator 2012

Përcjellja e braktisjes dhe mosvijimit të shkollave në Kosovë

Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport paraqiten gjetjet kryesore të një hulumtimi të kryer nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE) gjatë vitit 2011 për braktisjen e shkollës në Kosovë. Ai tregon për një mungesë të konsiderueshme të të dhënave të besueshme e zyrtare në lidhje me braktisjen e shkollës, kryesisht për shkak të mekanizmave të papërshtatshëm të mbikëqyrjes pranë shkollave dhe institucioneve tjera përgjegjëse. Me qëllim të ndërgjegjësimit të hisedarëve kyç për nevojën e fuqizimit të përpjekjeve të tyre për përcjelljen e vijimit të shkollës dhe zvogëlimin të braktisjes, posaçërisht ndër grupet e cënueshme, OSBE-ja i rekomandon hisedarëve kyç zbatimin e plotë të kornizës ligjore dhe të politikave që rregullon të drejtën e arsimit – duke përfshirë Planin e veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009–2014.

Hyrje

Arsimi është një e drejtë themelore e njeriut, thelbësore për zhvillimin e plotë të gjithë fëmijëve dhe realizimit të shumë të drejtave të tjera të njeriut në Kosovë. Një element i rëndësishëm i së drejtës për arsim është përfundimi i shkollimit fillor të detyrueshëm dhe falas dhe për rrjedhim zvogëlimin e braktisjes. Në Kosovë, ka tregues se braktisja e shkollës ndodh posaçërisht ndër grupet ose komunitetet e cënueshme dhe të marginalizuara. Në mënyrë që të sigurojnë vijimin e plotë dhe të barabartë të gjithë fëmijëve të moshës shkollore në arsimin fillor në Kosovë, institucionet duhet të regjistrojnë dhe nga afër të mbikëqyrin të dhënat e arsimit të zërthyer në bazë të gjinisë, komunitetit dhe faktorëve të tjerë gjegjës.

Veprimtaritë e monitorimit të OSBE-së dhe kërkimet në terren për braktisjen e shkollës u kryen nga muaji prill deri në muajin nëntor të vitit 2011. Të dhënat u mblodhën përmes intervistave me drejtorët e 83 shkollave fillore dhe të mesme të ultë që punojnë sipas kurrikulës së Kosovës në 24 komuna, si dhe me drejtorët komunalë të arsimit, nxënësit dhe përfaqësuesit e MASHT-it dhe organizatat e tjera vendase dhe ndërkombëtare aktive në fushën e arsimit.¹

¹ Komunitat dhe shkollat u përzgjedhën për të siguruar një baraspeshë ndërmjet vendbanimeve urbane dhe rurale, si dhe ndërmjet komuniteteve. Intervistat u mbajtën në Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Gjiilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot,

Pas përvijimit të kornizës ligjore dhe të politikave për të drejtën e arsimit, në këtë raport paraqiten gjetjet kryesore të hulumtimit të OSBE-së dhe nënvizohen boshllëqet serioze në të dhënat aktuale në dispozicion, si dhe të mekanizmave të mbledhjes së të dhënave dhe të monitorimit. Ai përfundon me një gamë të rekomandimeve për secilin hisedar gjegjës.

Korniza ligjore dhe e politikave

Korniza ligjore dhe e politikave e Kosovës përcakton përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës në fushën e arsimit që janë të rëndësishme për mbikëqyrjen e vijimit dhe zvogëlimin të braktisjes. Ligji për arsim fillor dhe të mesëm përcakton që MASHT “planifikon, bashkërendon dhe mbikëqyr zhvillimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm” në bashkëpunim me komunat.² Në përputhje me Ligjin për arsimin parauniversitar, MASHT ka gjithashtu mandat për të hartuar dhe mirëmbajtur një sistem menaxhimi të informatave në arsim për të mbikëqyrur, veç trendeve të tjera, braktisjen e shkollës.³ Plani i veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009–2014 më tej përcakton që MASHT duhet të grumbullojë dhe përpunojë të dhëna dhe të raportojë për regjistrimin në shkollë dhe braktisjen, si dhe përcakton që shkollat – me mbështetjen e drejtorëve komunalë për arsim – mbikëqyrin dhe raportojnë për vijimin e nxënësve në fund të secilit gjysëmvetor.⁴ Në mbështetje të kësaj, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011–2016 përcakton që të gjitha shkollat mbajnë “evidencë të saktë të rasteve të braktisjes”.⁵

Duke njohur raportin ndërmjet arsimit dhe mundësive të punësimit për një standard të duhur të jetesës dhe të drejtave të tjera të njeriut, Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2009-2015⁶ më tej thekson nevojën për të vënë prioritet ndërgjegjësimin e komuniteteve të cënueshme – gratë dhe vajzat në mesin tyre – për të siguruar qasjen e tyre të barabartë në arsim.⁷ Strategjia thekson që një ndërgjegjësim i tillë është posaçërisht i nevojshëm për të adresuar shkallën e ulët të vijimit të komuniteteve në arsimin e detyrueshëm fillor, si dhe shkallën e dobët të shkrim-leximit dhe regjistrimit në nivelet e larta, gjë që pasqyrojnë qasjen e tyre të

Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërdë, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina dhe Vushtrri/Vučitrn. Shkollat që punojnë sipas kurrikulës së Serbisë nuk u përfshinë në këtë hulumtim. OSBE-ja gjithashtu intervistoi përfaqësuesit në Prishtinë/Priština të Këshillit të Evropës, Fondit të Fëmijëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNICEF), Agjencisë Gjermane për Zhvillim “*Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit*” (GIZ) dhe të organizatave joqeveritare *Balkan Sunflowers*, Qendrës Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë dhe Qendrës për Dokumentim të Romëve dhe Ashkalive.

² Nenet 11 dhe 18 të Ligjit nr. 2002/2 për arsimin fillor dhe të mesëm, i shpallur me anë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/19, 31 tetor 2002.

³ Neni 5.1.6 i Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Kosovë, 16 shtator 2011.

⁴ Qëllimi 2 i planit të veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009–2014, miratuar nga MASHT në vitin 2009. Vendimi i MASHT-it nr. 375/02-1 2006 po ashtu udhëzon drejtorët e shkollave për të raportuar mbi braktisjen e shkollës.

⁵ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011–2016, f. 78, http://www.entwicklung.at/uploads/media/2c_Kosovo_Education_Strategic_Plan_EN_FINAL_DRAFT.pdf (qasur më 11 korrik 2012). Plani strategjik i arsimit përfshin planin e veprimit kundër braktisjes së shkollës, po aty.

⁶ Zyra e Kryeministrit, *Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë*, dhjetor 2008.

⁷ Nenet 1.2 dhe 2.2, po aty.

pabarabartë dhe të papërshtatshme në arsim për shkak të formave strukturore, sociale dhe të tërthorta të diskriminimit.⁸

Prandaj korniza ligjore dhe e politikave e Kosovës është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtën e njeriut për arsim që përcakton jo vetëm arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas, por edhe miratimin e masave të përkohshme të veçanta për ta luftuar braktisjen dhe përmirësimin e shkallës së vijimit, posaçërisht ndër grupet e cenueshme, gratë dhe vajzat.⁹ Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare¹⁰, që është e një rëndësie të veçantë për kontekstin evropian, më tej përcakton që institucionet “duhet të angazhohen për nxitjen e mundësive të barabarta për ndjekjen e arsimit në të gjitha nivelet për personat të cilët i përkasin pakicave kombëtare”¹¹. Në grupin e saj të dytë të rekomandimeve për zbatimin e Konventës Kornizë në Kosovë, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës i bëri thirrje institucioneve të Kosovës që të “shtojnë përpjekjet për të siguruar qasjen e barabartë në arsim për të gjithë personat të cilët i përkasin komuniteteve pakicë” për të adresuar pabarazitë e qarta dhe të dukshme në sistemin arsimor përmes reformave institucionale të synuara.¹²

Për të zbatuar kornizën ligjore dhe të politikave, si dhe për të realizuar të drejtën e njeriut për arsim, institucionet e Kosovës duhet në mënyrë metodologjike të mbikëqyrin dhe të çojnë përpara qasjen e barabartë në arsim, përmes treguesve të duhur dhe standardeve në bazë të mbledhjes së të dhënave të zberthyer të arsimit.¹³

⁸ Po aty.

⁹ Neni 26 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Rezoluta 217A e AP (III), 10 dhjetor 1948, A/810 at 71; Neni 26 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966, 999 UNTS 171; Neni 28 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, 1989, 1577 UNTS 3; Neni 10 i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, 1979, 1249 UNTS 13; Neni 2 i Protokollit nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS 9). Të gjitha këto dispozita të traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut zbatohen drejtpërdrejtë në gjykatat e Kosovës, në bazë të përfshirjes së tyre në Kushtetutën e Kosovës së vitit 2008. Për më tepër thelb të saktë mbi detyrimet e autoriteteve sipas DUDNJ, shih po ashtu: nenet 13 dhe 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore 1966, 993 UNTS 3; si dhe *Komentin e përgjithshëm nr. 13: e drejta për arsim* të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK) E/C.12/1999/10 (“KDESK, komenti i përgjithshëm nr. 13”).

¹⁰ Konventë Korniza për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995, 2151 UNTS 24.

¹¹ Neni 12(3), po aty.

¹² Këshilli i Evropës, Komiteti këshillëdhënës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare “Mendimi i dytë për Kosovën” (i miratuar më 5 nëntor 2009), ACFC/OP/II(2009)004, Strasburg, 31 maj 2010, Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, rekomandimet e dyta përkitazi me zbatimin e Konventës Kornizë në Kosovë, të miratuara nga Komiteti i Ministrave më 6 korrik 2011 në mbledhjen e 1118 të zëvendësministrave në Strasburg (rekomandimet e dyta të Komitetit të Ministrave). Shih: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_fcnmdocs/PDF_2nd_OP_Kosovo_en.pdf dhe <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1812633> (qasur më 11 korrik 2012).

¹³ Duke pasur parasysh se korniza ligjore gjegjëse shprehimisht përcakton që institucionet duhet të ndërmarrin përpjekje drejt qasjes së barabartë në arsim për të gjithë personat, komunitetet dhe gjinitë – duke përfshirë masat e veçanta për të plotësuar çfarëdo boshllëku të vijimit – çdo përpjekje për ta respektuar atë kornizë kërkon përcjelljen e regjistrimit të atyre grupeve të veçanta gjegjëse përmes të dhënave të zberthyer në ato baza. Për më tepër mbi natyrën e këtyre kërkesave të procesit, të nevojshme për ta respektuar të drejtën për arsim siç përcaktohet me anë të DUDNJ, shih: KDESK, komenti i përgjithshëm nr. 13, paragrafët 37 dhe 52, fusnota 9 më sipër.

Mungesa e të dhënave të sakta, të plota dhe të besueshme

Sipas MASHT-it, shkalla e përgjithshme e regjistrimit në arsimin e mesëm të ulët ka mbetur e lartë përgjatë pesë viteve të kaluara dhe shkalla zyrtare e braktisjes në arsimin e detyrueshëm lëviz nga 0.6 deri në 0.8 për qind që nga viti 2006, kryesisht nën mesataren rajonale.¹⁴ Megjithatë, OSBE-ja në hulumtimin e vet gjeti që këto të dhëna statistike zyrtare nuk sigurojnë informata të besueshme dhe të plota për braktisjen e shkollës. Në vitin shkollor 2008/2009, MASHT raportoi që 103.9 për qind e fëmijëve të moshës së shkollimit fillor ishin regjistruar në vitin e parë të arsimit fillor.¹⁵ Për më tepër, 37 për qind e shkollave të anketuara nuk mbledhin asnjë të dhënë për braktisjen apo pohojnë se nuk ka pasur raste të braktisjes gjatë tri viteve të kaluara – një perceptim kryesisht i pambështetur.¹⁶

Të dhënat që mblidhen nga drejtoritë komunale të arsimit nuk përputhen gjithmonë me atë se çka i kanë raportuar drejtorët e shkollave OSBE-së, gjë e cila dëshmon për metoda të mangëta të mbledhjes së të dhënave dhe mungesë së shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve. Për shembull, në komunën e Prishtinës/Priştina drejtori i arsimit tregoi që në një shkollë të veçantë kishte dy braktisje në vitin shkollor 2008/2009 dhe katër të tilla në vitin shkollor 2009/2010, ndërsa drejtori i shkollës besonte se të njëjtit nxënës ende ishin të regjistruar.

Gjatë hulumtimit të OSBE-së për këtë raport, asnjë zyrtarë komunalë ose i shkollës që u intervistuan për arsyet e braktisjes së shkollës nuk mund të mbështeste përgjigjet e tyre në shifra apo fakte konkrete. Ndonëse shumë shkolla të anketuara dukej se mbanin shënime për regjistrimin e nxënësve, shumë pak prej tyre kishin shënime të plota për braktisjen e shkollës.

¹⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Arsimi i Kosovës në shifra 2008/09*. Shih: http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Arsimi_i_Kosov%C3%ABs_n%C3%AB_shifra.pdf (qasur më 1 gusht 2012). Sipas Institutit të Statistikave të UNESCO, shkalla e braktisjes për arsimin fillor në Shqipëri është 10 për qind (2003), në Rumani 4.7 për qind (2003) dhe 5.6 për qind në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (2005). Shih: <http://www.uis.unesco.org/Pages/default.aspx> (qasur më 1 gusht 2012).

¹⁵ Arsimi i detyrueshëm në shkollat sipas kurrikulës së Kosovës përbëhet nga arsimi fillor dhe i mesëm i ulët. Arsimi fillor përfshin klasat 1 deri 5, me nxënës të moshës 6 deri 11 vjeç; shkolla e mesme e ulët janë klasat 6 deri në 9, me nxënës të moshës 11 deri 15 vjeç. Neni 7i Ligjit nr. 2002/2 për arsimin fillor dhe të mesëm, siç është shpallur me anë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/19, 31 tetor 2002; Neni 9.2 i Ligjit për arsimin parauniversitar, po aty. Shifra prej 103.9 për qind është e mbështetur në regjistrimin e përgjithshëm të 176,469 nxënësve në klasën e parë të shkollës fillore; 169,887 përfaqësojnë përafërsisht 100 për qind të nxënësve të moshës 6 vjeçare (mosha e arsimit të detyrueshëm) kurse shifra e mbetur prej 3.9 për qind përfshin ata të cilët u regjistruan para moshës 6 vjeçare apo pas moshës 7 vjeçare. Shih Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Arsimi i Kosovës në shifra 2008/09*, f. 34. Shih: http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Arsimi_i_Kosov%C3%ABs_n%C3%AB_shifra.pdf (qasur më 1 gusht 2012).

¹⁶ Shifra prej 37 për qind përshin: të tria shkollat e anketuara në komunën e Dragashit/Dragaš; dy prej tri shkollave të anketuara në Fushë Kosovë/Kosovo Polje; të gjitha katër shkollat e anketuara në Kamenicë/Kamenica; dy nga katër shkollat e anketuara në Klinë/Klina, shkollën e vetme të anketuar në Klokot/Kllokot; dy nga katër shkollat e anketuara në Mitrovicë/Mitrovica; një nga dy shkollat e anketuara në Novo Brdo/Novobërdë; një nga katër shkollat e anketuara në Pejë/Peć; tri nga katër shkollat e anketuara në Podujevë/Podujevo; tri nga katër shkollat e anketuara në Prishtinë/Priştina; katër nga shtatë shkollat e anketuara në Prizren; një nga katër shkollat e anketuara në Skenderaj/Srbica; shkollën e vetme të anketuar në Štrpce/Shtërpçë; dy nga katër shkollat e anketuara në Viti/Vitina dhe tri nga katër shkollat e anketuara në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn.

Dështimi për të zbërthyer të dhënat për regjistrim gjithashtu vështirëson nxjerrjen e konstatimeve nga informatat që janë në dispozicion, të tilla si shkalla dhe shkaqet e braktisjes dhe trendët e mosvijimit, të dyja në përgjithësi dhe në mesin e grupeve ose komuniteteve të prekura në mënyrë diproporcionale në vendbanime të ndryshme. Deri më sot, MASHT ka zbërthyer të dhënat për regjistrim vetëm në bazë të gjinisë, ndonëse një mori e treguesve gjegjës të performancës për qasje të barabartë janë të përfshirë në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë.¹⁷ Për më tepër, shkollat nuk zërthejnë në mënyrë të qëndrueshme të dhënat e tyre të përgjithshme të regjistrimit në kategori të caktuara, të tilla si transferimet, braktisjet dhe regjistrimet e reja, që do të thotë se shkollat nuk janë në gjendje që të përcjellin ndryshimet numerike ndër këto kategori.

Në shkollat e anketuara që mbajnë çfarëdo të dhënash për braktisjen, ato zakonisht i zërthejnë sipas gjinisë ndonëse jo gjithmonë sipas komunitetit, edhe në ato shkolla në të cilat vijojnë mësimin nxënësit nga disa komunitete. Për shembull, në komunat Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtri/Vučitrn asnjëra prej shkollave të anketuara nuk kishte zbërthyer të dhënat sipas komuniteteve. Shumica e drejtorëve të shkollave, të cilët u intervistuan, gjithashtu nuk mbajnë shënime dhe nuk raportojnë se kur dhe përse ka pasur braktisje. Shumë të dhëna aktualisht mblidhen në një formë që tregon vetëm nëse një fëmijë është i regjistruar në shkollë apo jo, pa asnjë referencë ndaj faktorëve që i kontribuojnë braktisjes ose trendëve të ulët të vijimit. Sipas sistemit ekzistues të mbledhjes së të dhënave, del që institucionet e arsimit nuk kanë mjete teknike për të përcjellë ata fëmijë të cilët asnjëherë nuk janë regjistruar në shkollë.

Në veçanti, asnjë prej komunave të anketuara ku jetojnë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës nuk kanë të dhëna mbi numrin e fëmijëve të cilët i përkasin këtyre komuniteteve e të cilët nuk janë të regjistruar në moshën 6 vjeçare, ashtu siç është e përcaktuar. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, organizata joqeveritare *Balkan Sunflowers* vërejt një përqindje të lartë të braktisjes së shkollës – veçanërisht në mesin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovë – përqindje që nuk ishte e paraqitur në të dhënat që zyrtarët e shkollave ia paraqitën OSBE-së.¹⁸ Treguesit e tillë duhet të nxisin institucionet e nivelit komunal dhe atij qendror që të kryejnë veprimtari ndërgjegjësimi dhe që të miratojnë masa të tjera të nevojshme për të siguruar që fëmijët e moshës shkollore nga komunitetet e cenueshme janë të regjistruar në baza të barabartë, pa marrë parasysh gjendjen e tyre socio-ekonomike.

Sistemi i papërshtatshëm i mbikëqyrjes

Cilësia e dobët e të dhënave për arsimin dëshmon papërshtatshmërinë dhe pasigurinë e metodave të mbikëqyrjes që përdoren nga MASHT-i dhe institucionet komunale për të përcjellë braktisjen e shkollës dhe mosregjistrimin. Në mungesë të një sistemi mbikëqyrës që mblidh të dhëna të zërthyer, mbi bazën e së cilave mund të punohet, zyrtarët e intervistuar nga OSBE-ja mbështeten më shumë në bindjet personale anekdotike dhe të pabazuara sesa në matjet objektive të braktisjes së shkollës dhe

¹⁷ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016, fusnota 5 më sipër. Shih, për shembull, kapitullin 7 “Monitorimi i performancës së sektorit të arsimit”, f. 159-168. Shih: http://www.masht.gov.net/advCms/documents/KESP_2011_2016.pdf (qasur më 1 gusht 2012).

¹⁸ Intervistë me përfaqësuesin e *Balkan Sunflowers*, Prishtinë/Priština, 27 tetor 2011.

mosvijimit. Për shembull është shumë e përhapur bindja se nuk ka fare braktisje të shkollës. Si pasojë e kësaj, një e treta e shkollave të anketuara raportuan se arsyeja pse nuk mbajnë të dhëna për braktisjen e shkollës është numri i ulët i pohuar i braktisjeve në shkollat e tyre gjegjëse.¹⁹ Drejtori komunal i arsimit në Prishtinë/Priština²⁰ dhe gjashtë drejtorët e shkollave të intervistuar në komunat Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Prishtinë/Priština dhe Pejë/Peć²¹ më tej sugjeruan se braktisjet janë një dukuri “kulturore” që kryesisht prekin komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Të tjerët deklaruan se nxënësit po braktisnin shkollën vetëm gjatë klasave të larta të arsimit të detyrueshëm.²²

Dështimi për të reaguar ndaj cilitdo trend – të vërtetë a të perceptuar – ngjashëm do të ishte dështim i institucioneve arsimore të Kosovës për të respektuar kornizën ligjore dhe të politikave që përcakton mbikëqyrjen aktive të braktisjeve dhe regjistrimit në arsimin fillor të detyrueshëm për fëmijët nga të gjitha komunitetet.

Çështja e braktisjes së shkollës nuk kuptohet ashtu siç duhet nga të gjithë zyrtarët komunalë dhe të shkollave që janë përgjegjës për adresimin e saj. Braktisjet në përgjithësi llogariten në bazë të ndryshimit midis numrit të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor dhe numrit të nxënësve që mbesin në fund të vitit shkollor. Kjo metodë dështon të merr parasysh gjendjet e tjera që shtojnë nxënësit ta lënë shkollën, të tilla si transferimet në shkollat tjera, vdekjet ose largimi nga Kosova, dhe si pasojë minon llogaritjen e saktë të braktisjeve të shkollës. Transferimet e nxënësve nga një shkollë me kurrikulë të Kosovës në tjetrën nuk regjistrohen në mënyrë të duhur si të tilla dhe mund të shtojnë apo ulin shkallën e braktisjes kur llogariten si të pasakta.

Përkundër futjes në përdorim nga MASHT të një sistemi më të përsosur të mbledhjes së të dhënave në vitin 2002, ende ka mospërputhje për shkak të mungesës së protokolleve mbikëqyrëse të njëtrajtshme, të rregullta dhe efikase brenda shkollave.²³

¹⁹ Dy shkolla në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, një shkollë në komunën e Prishtinës/Priština, një shkollë në komunën e Podujevës/Podujevo, tri shkolla në komunën e Dragashit/Dragaš, një shkollë në komunën e Prizrenit dhe dy shkolla në komunën e Vitisë/Vitina.

²⁰ Intervistë personale me drejtorin për arsim në komunën e Prishtinës/Priština, Prishtinë/Priština, 26 prill 2011.

²¹ Intervista personale me gjashtë drejtorët e shkollave në komunat Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Prishtinë/Priština dhe Pejë/Peć, prill 2011.

²² Intervistë personale me drejtorin për arsim në komunën e Prishtinës/Priština, Prishtinë/Priština, 26 prill 2011. Intervista me katër drejtorët e shkollave në komunën e Mitrovicës/Mitrovica dhe të një shkollë në komunën e Mamuşa/Mamushës/Mamuša, prill 2011.

²³ Me nismë dhe mbështetje nga Banka Botërore, MASHT themeloi në vitin 2002 një sistem të menaxhimit të informatave në arsim. Ai ka për qëllim mbledhjen, përpunimin, raportimin, monitorimin, vlerësimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore dhe të treguesve gjegjës të arsimit. Megjithatë sistemi nuk u shtri në të gjitha shkollat deri në shtator të vitit 2011, përmes një programi të ri softuerik. Si pasojë e kësaj, në kohën e vlerësimit drejtorët e shkollave ende po përdornin formularët e ndryshëm për përcjelljen e braktisjes. Ndër shkollat e anketuara që mbanin të dhëna për braktisjen, disa përdornin formularët e MASHT-t, disa formularët e SOK dhe të tjerat përdornin vetë shënimet e tyre. Njëmbëdhjetë drejtorë të shkollave raportuan se mbajnë shënime të shkruara me dorë. Kjo për shkak të asaj se ata nuk kanë pajisje elektronike të mirëmbajtura mirë apo për shkak se nuk janë të trajnuar për përdorimin e teknologjisë informative. Përveç kësaj, shkollat mblodhën të dhënat për braktisjen në kohë të ndryshme përgjatë vitit shkollor: disa në fund të vitit, disa në fund të secilit gjysmëvit dhe disa të tjera në fund të një cikli shkollor. Më saktë, drejtorët e shkollave – me mbështetjen e drejtorëve komunalë për arsim – kanë për detyrim mbledhjen e të dhënave për braktisjet në mënyrë të vazhdueshme si dhe raportimin e tyre në fund të secilit gjysmëvit. Shih fusnotën 4 më sipër.

Dështimi i MASHT për të shpërndarë udhëzime të qarta për mbledhjen e të dhënave dhe për të shqiptuar procedura të detyrueshme për zyrtarët komunalë dhe drejtorët e shkollave minon edhe më tej respektimin e kornizës së zbatueshme ligjore dhe të politikave. Shumë drejtorë të shkollave i thanë OSBE-së se ata nuk i kushtojnë vëmendje të veçantë braktisjes së shkollës për shkak se nuk kanë pranuar ndonjë udhëzim gjegjës nga komunat apo niveli qendror. Ngjashëm, drejtorët komunalë të arsimit nuk kërkojnë në mënyrë sistematike nga shkollat mbledhjen e të dhënave, arkivimin dhe menaxhimin e informatave. Cilësia e raportimit gjithashtu lidhet me kujtesën institucionale të shkollave. Shumica e drejtorëve të porsaemëruar të shkollave mund të siguronin të dhënat që ishin mbledhur nga fillimi i detyrës së tyre.

Rekomandimet

Në bazë të hulumtimit për braktisjen e shkollës në tërë Kosovën dhe për sfidat e shkaktuara nga mungesa e një sistemi të mirëfilltë të mbledhjes së të dhënave dhe mbikëqyrjes, OSBE-ja rekomandon që institucionet e Kosovës duhet të bashkërendojnë dhe të shtojnë përpjekjet e tyre në të gjitha nivelet për të mbikëqyrur dhe luftuar braktisjen e shkollës dhe mosregjistrimin, në përputhje me të drejtën e njeriut për arsim siç përcaktohet me kornizën ligjore dhe të politikave të Kosovës. Zbatimi i plotë i kësaj kornize, duke përfshirë të gjitha veprimtaritë që parashihen në qëllimet e Planit të veprimit kundër braktisjes së shkollës, do të kontribuonte në rezultate më të mira ekonomike, të sigurisë dhe të shëndetit publik. Të sigurosh që të gjithë fëmijët përfundojnë shkollimin e detyrueshëm është thelbësor për zhvillimin afatgjatë politik, ekonomik dhe social, si dhe është i nevojshëm për realizimin e plotë të shumë të drejtave të tjera të njeriut të ndërvarura.²⁴ Mekanizmat e përmirësuar dhe protokollat për mbledhjen e të dhënave të zberthyer, me të cilat mund të punohet, do t'i ndihmonte jo vetëm zyrtarëve për të mbikëqyrur dhe për të reaguar në mënyrë të duhur ndaj braktisjeve në shkollë, por gjithashtu do të ndihmonte në mënjanimin e diskriminimit ndaj gruas dhe ndaj komuniteteve në pozitë të pafavorshme duke siguruar mundësi të barabarta dhe një mjedis të përbashkët në mesin e grupeve të ndryshme shoqërore brenda shoqërisë.

Duke e pasur parasysh atë që u tha më lartë dhe në kuptim të garantimit të së drejtës për arsim për të gjithë fëmijët në Kosovë, OSBE-ja i këshillon hisedarët gjegjës që të shqyrtojnë rekomandimet si në vijim:

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

- Të sigurojë zbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e institucioneve komunale të arsimit për mbledhjen e të dhënave të sakta afatgjate cilësore dhe sasiore për braktisjet, të zberthyer në bazë të gjinisë, komunitetit dhe çfarëdo kategorie tjetër gjegjëse.
- Të kërkojë përdorimin e një sistemi menaxhimi të informatave në arsim në të gjitha shkollat me kurrikulë të Kosovës, përmes përcaktimit të standardeve të qarta dhe të drejtpërdrejta për atë se si shkollat duhet të përcjellin braktisjet.
- Të sigurojë që transferimet ndërmjet shkollave dhe arsyet e tjera të nxënësve për largim nga shkolla të regjistrohen në mënyrë të saktë dhe të duhur në të gjitha rastet.

²⁴ Shih paragrafin 1 të komentit të përgjithshëm nr. 13 të KDESK, fusnota 9 më sipër.

- Të ofrojë udhëzime për drejtoritë komunale për arsim për atë se si të zbatohen kërkesat për mbledhjen e të dhënave dhe pjesët e tjera të Planit të veprimit kundër braktisjes së shkollës.

Për drejtoritë komunale të arsimit:

- Të punojnë ngushtë me të gjithë drejtorët e shkollave për të mbikëqyrur përqindjet e braktisjes së shkollës dhe vijimit në baza të rregullta dhe t'i raportojnë në mënyrë sistematike MASHT-it.
- Të bashkëpunojnë si me MASHT-in ashtu edhe me të gjithë drejtorët e shkollave për të ngritur vetëdijesimin rreth dhe për zbatimin e udhëzimeve për mbledhjen e të dhënave në planin e veprimit kundër braktisjes së shkollës.
- Të hetojnë në mënyrë aktive dhe t'i korrigjojnë rastet e mosregjistrimit në shkolla, duke përfshirë përcjelljen e vijimit të fëmijëve të moshës shkollore në komunat gjegjëse.

Për drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit:

- Të mbikëqyrin në mënyrë aktive rastet dhe arsyet e mosvijimit dhe braktisjes në baza ditore, mujore dhe vjetore – si dhe brenda ciklit të vitit shkollor – dhe t'i raportojnë këto gjetje tek drejtoritë komunale për arsim për çdo gjysëmvetor me të dhënat e zbërthyer në bazë të gjinisë, komunitetit dhe çfarëdo kategorie tjetër gjegjëse.
- Të kërkojnë në mënyrë aktive t'i gjejnë nxënësit të cilët mungojnë dhe prindërit e tyre për të identifikuar faktorët që qëndrojnë pas mungesës në shkollë të fëmijës dhe për ta nxitur vijimin.

Për organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare:

- T'i inkurajojnë dhe mbështesin institucionet e Kosovës që t'i mbikëqyrin dhe luftojnë braktisjet në mënyrë të shpejtë dhe efikase, si dhe që t'i përmirësojnë kapacitetet e tyre për të përcjellë dhe për të reaguar ndaj dallimeve në vijim të shkollës ndërmjet segmenteve të ndryshëm të popullatës.